

L I G J
Nr.7523, datë 6.11.1991

PËR NDËRMARRJET SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ndërmarrja shtetërore, që më poshtë do të quhet ndërmarrje, është pronë e shtetit.
Ndërmarrja është person juridik.

Neni 2

Ndërmarrja, në pajtim me objektin e caktuar në aktin e krijimit të saj, ushtron një ose disa veprimtari kryesore prodhimi, tregtie, punimi, ndërtimi ose shërbimi, si dhe veprimtari me karakter plotësues (të dyta).

Ndërmarrja ushtron vepritarinë në mënyrë të pavarur, në kushtet e konkurrencës me subjektet e tjera ekonomike.

Neni 3

Ndërmarrja për kryerjen e veprimtarive të saj, hyn në marrëdhënie të lira ekonomike e financiare me persona juridikë a fizikë, të huaj dhe me kapital të përbashkët.

Neni 4

Ndërmarrjet me të ardhura që kanë të përballojnë shpenzimet, detyrimet ndaj shtetit dhe të sigurojnë fitim, me përjashtim të atyre që financohen nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Ndërmarrjet klasifikohen në:

- a) Ndërmarrje nacionale,
- b) Ndërmarrje lokale.

Kriteret dhe mënyra e klasifikimit të tyre përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Ndërmarrja është e detyruar ta zhvillojë vepritarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

KREU II
KRIJIMI BASHKIMI NDARJA DHE LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE

Neni 7

Ndërmarrjet nacionale krijohen, bashkohen, ndahen, shkrihen ose shpërndahen me urdhër të ministrit a të drejtuesit të institucionit tjetër qendror.

Ndërmarrjet lokale krijohen, bashkohen, ndahen, shkrihen ose shpërndahen me vendim të organeve të pushtetit lokal.

Neni 8

Akti për krijimin, ndarjen ose bashkimin e ndërmarrjes duhet të përmbajë:

- a) Firmën e ndërmarrjes (emrin e plotë dhe të shkurtuar të saj).
- b) Inventarin e mjeteve kryesore dhe të mjeteve të xhiros në sasi e në vleftë.
- c) Objektin e veprimtarisë.
- ç) Emrin e organit qendror, në sistemin e të cilit bën pjesë.
- d) Vendndodhjen e ndërmarrjes.

Neni 9

Krijimi, ndarja ose bashkimi i ndërmarrjes regjistrohen: Për ndërmarrjet nacionale në Ministrinë e Financave, kurse për ndërmarrjet lokale në seksionin e financës të organeve të pushtetit lokal.

Ndërmarrja fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në gjykatë.

Neni 10

Regjistrimi i ndërmarrjes bëhet në bazë të këtyre dokumenteve:

- a) Akti i themelimit, ndarjes ose bashkimit.
 - b) Statuti i ndërmarrjes
 - c) Deklarata e drejtorit të ndërmarrjes
- Regjistrimi i ndërmarrjes bëhet brenda 15 ditëve nga data e krijimit, bashkimit ose ndarjes. Organi që ben regjistrimin, i lëshon ndërmarrjes aktin e krijimit.

Neni 11

Ndërmarrja e pushon veprimtarinë e saj kur:

- a) Mbyllet nga organi kompetent si pasojë e shkeljes së dispozitave në fuqi.
 - b) Për arsye riorganizimi nga organi prej të cilit varet.
 - c) Deklarohet e falimentuar financiarisht.
 - ç) Në raste të tjera të parashikuara me ligj.
- Mënyra e likuidimit të pasurisë ose falimentimi rregullohet me dispozita të veçanta.

KREU III MARRËDHËNIET EKONOMIKE TË NDËRMARRJES

Neni 12

Ndërmarrja është njësi e pavarur për ushtrimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare.

Neni 13

Ndërmarrja siguron dhe shton mjetet e përhershme për ushtrimin e veprimtarisë së saj nëpërmjet:

- a) Kapitalit të themelimit që i është vënë në dispozicion në kohën e krijimit të saj nga shteti.
- b) Kapitalit shtesë që i jepet nga shteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- c) Fitimeve të saj.

Ndërmarrja siguron mjete financiare të përkohshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj nëpërmjet huave dhe kredive afatgjata e afatshkurtra, si dhe nëpërmjet mobilizimit të përkohshëm të mjeteve të të tretëve.

Neni 14

Ndërmarrja gazon të drejtën e përdorimit dhe të disponimit të vlerave me përdorim afatgjatë (mjete kryesore), si dhe të vlerave qarkulluese (mjete xhiroje), të krijuara me kapitalin shtetëror dhe me fitimin e saj.

Ndërmarrja mund të vërë në shitje, në kushtet e parashikuara me ligj, elemente pasurore që ka në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë, kur këto janë të tepërta ose të panevojshme.

Neni 15

Ndërmarrja në mënyrë të pavarur harton programin për veprimtarinë ekonomike e financiare mbi bazën e kontratave dhe të marrëveshjeve të lidhura, porosive të shtetit, mundësive që ajo parashikon për shitje drejtpërdrejte në treg etj. Ajo vetë cakton strukturën e prodhimit, siguron bazën materialo-teknike, investime dhe ndërtime, fuqinë punëtore, konsumatorët, e zëra të tjerë të kësaj natyre.

Neni 16

Shteti rregullon marrëdhëniet ekonomike me ndërmarrjen nëpërmjet sistemit të tatimeve dhe taksave, subvencioneve, përqindjeve të interesit caktimit të pagës minimale të punës, normave minimale të amortizimit, rregullave për formimin e çmimeve dhe porosive shtetërore.

Neni 17

Porositë shtetërore u caktohen ndërmarrjeve vetëm për bilancet kryesore kombëtare, për detyrat e politikës sociale për arritjen e qëllimeve strategjike, teknologjike e tregtare, për garantimin e sigurimit kombëtar, si dhe për plotësimin e detyrave ndërkombëtare të marra përsipër.

Neni 18

Për plotësimin e porosive shtetërore, ndërmarrja angazhohet dhe me pëlqimin e saj, lidhë kontratë ose marrëveshje. Ato nuk mund të angazhojnë më shumë se 2/3 e kapacitetit të ndërmarrjes. Me pëlqimin e saj ndërmarrja mund të pranojë porosi nga shteti deri në 100 për qind të kapacitetit të saj prodhues.

Për disa veprimtari të specializuara, e me rëndësi të veçantë për ekonominë si gjeologji, shpim-kërkime në nafta e të tjera të kësaj natyre, porosia shtetërore caktohet nga Këshilli i Ministrave deri në kapacitetin e plotë.

Neni 19

Ndërmarrja organizon dhe përgjigjet për shërbimin statistikor në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 20

Çmimet e mallrave dhe të shërbimeve, si dhe për manualët e studimit e të ndërtimit, vendosen në përputhje me kërkesat dhe ofertën e tregut. Çmimet konkrete caktohen me kontratë ose marrëveshje.

Për mallra e shërbime të caktuara e me rëndësi për nivelin e jetesës së popullit, organet shtetërore dhe ekonomike kompetente caktojnë çmime me pakicë fikse ose kufi.

Çmimet kufi të shitjes për lëndë të para, materiale, lëndë djegëse, energji elektrike dhe

shërbime transporti caktohen sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 21

Ndërmarrjet kryejnë lirisht çdo lloj veprimtarie ekonomike me persona juridikë a fizikë të huaj, pa qenë nevoja për ndonjë akt të organeve shtetërore, me përjashtim të rastëve të parashikuara me dispozita të veçanta.

Neni 22

Ndërmarrjet sigurojnë mjetet e veta valutore nëpërmjet eksportit të mallrave dhe shërbimeve, kredisë valutore nga Banka e Shtetit Shqiptar, blerjes së valutës nga shteti dhe nga tregjet valutore. Ndërmarrja merr kredi valutore nga bankat e huaja, për të cilën njofton Bankën e Shtetit Shqiptar.

Neni 23

Ndërmarrja ka të drejtë të investojë në ndërmarrje a institucione të tjera dhe të disponojë aksione në ndërmarrje të tjera, sipas dispozitave në fuqi. Ndërmarrja ka të drejtë të emetojë letra me vlerë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 24

Ndërmarrja cakton pagën e punës për çdo punonjës, por jo më të vogël se paga minimale e miratuar nga Këshilli i Ministrave, shtesa mbi paga, dietat, stimujt dhe numrin e punonjësve.

Neni 25

Ndërmarrja ka të drejtë të marrë në punë ose të largojë nga puna punonjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Drejtuesi i ndërmarrjes, lidh kontratën individuale të punës me çdo punonjës, ndërsa kontratat kolektive i lidh në marrëveshje me sindikatat.

Neni 27

Ndërmarrja cakton vetë mjetet për pagat e punës në përputhje me rregullat dhe treguesit që ajo ka vendosur.

Në përputhje me kushtet konkrete, paga e punës jepet orare, ditore, javore dhe mujore.

Neni 28

Madhësia e shpërblimit të punës të punëtorëve, specialistëve dhe kuadrove drejtues nuk kufizohet.

Neni 29

Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e ndërmarrjes ndaj të tretëve, përveç rasteve kur ai e merr vetë këtë përgjegjësi, sikurse edhe ndërmarrja nuk përgjigjet për detyrimet e shtetit ndaj të tretëve. Borxhet dhe detyrimet e ndërmarrjes kur ajo pushon veprimtarinë, likuidohen në përputhje me rregullat e caktuara me dispozita të veçanta.

Neni 30

Rezultati ekonomik i ndërmarrjes përfaqëson diferencën ndërmjet të ardhurave gjithsej të realizuara dhe shpenzimeve.

Neni 31

Të ardhurat gjithsej të ndërmarrjes përbëhet nga:

a) Shitja e mallrave të nisura, nga shërbimet dhe punimet e kryera, si dhe nga qarkullimi i mallrave.

b) Të ardhurat që realizohen nga dhënia në përdorim e mjeteve kryesore.

c) Interesat e mjeteve në të holla të depozituara në bankë ose dhënia në përdorim të tretëve.

ç) Të ardhurat që sigurohen nga veprimtaria kërkimore-shkencore dhe ndihmëse.

d) Subvensionet deri në çmimin me pakicë.

dh) Të ardhurat nga arkëtimi i gjobave si dhe të ardhura të tjera.

Të ardhurat totale përcaktohen sipas parimit të shitjeve të faturave dhe jo arkëtimeve të kryera.

Neni 32

Shpenzimet e lejueshme të ndërmarrjes përbëhet nga:

a) Vleftha e lëndëve të para, materialeve ndihmëse, lëndëve djegëse, energjisë elektrike e të tjera të kësaj natyre, të vlerësuara sipas çmimeve faktike të blerjes.

b) Fondi i amortizimit, i llogaritur në bazë të përqindjeve të amortizimit, që caktohet nga Ministria e Financave.

c) Shpenzimet faktike të pagave dhe sigurimeve shoqërore.

ç) Shpenzimet e shitjes, të mbrojtjes së mjedisit dhe reklamës.

d) Shpenzimet e përgjithshme të ndërmarrjes dhe repartit.

Neni 33

Ndërmarrja paguan tatim mbi qarkullimin e mallrave dhe tatim mbi fitimin sipas përcaktimeve të bëra me dispozita të veçanta.

Neni 34

Shumën e fitimit që mbetet pas zbritjes së tatimit, ndërmarrja e përdor sidomos:

a) Për shtimin sasior dhe përmirësimin cilësor të faktorëve materiale e teknike të veprimtarisë.

b) Për t'i stimuluar punonjësit.

c) Për krijimin e fondit të ndihmave shoqërore dhe të asistencës sociale.

ç) Për krijimin e kapitalit rezervë.

d) Për përmirësimin e kushteve të punës.

Neni 35

Shlyerja e kreditit dhe e interesit për prodhimet dhe veprimtaritë që lidhen me kreditë e investimeve, bëhet nga fitimi, përpara se ai të tatohet. Këto prodhime dhe veprimtari caktohen nga Ministria e Financave në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse.

Neni 36

Viti ushtrimor i ndërmarrjes i korrespondon vitit financiar të shtetit.

Neni 37

Ushtrimi financiar i ndërmarrjes bëhet sipas programit financiar, i cili hartohet e miratohet nga ndërmarrja për çdo vit ushtrimor dhe përfshin të ardhurat e shpenzimet e ndërmarrjes.

Neni 38

Ndërmarrja mban kontabilitet, përgatit dhe paraqet llogaritë vjetore sipas përcaktimeve me dispozita ligjore të veçanta.

Neni 39

Forma e programit financiar dhe rregullat për veprimtaritë financiare caktohen nga Ministria e Financave në bashkëpunim me ministrinë përkatëse.

Neni 40

Ndërmarrja çel llogari në lekë e në valutë në bankat shqiptare dhe me autorizim të bankës qendrore në bankat e huaja, sipas kriterëve të caktuara në dispozita të veçanta.

KREU IV ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I NDËRMARRJES

Neni 41

Ndërmarrja organizohet e funksionon si njësi më vete ose me filialet e saj brenda ose jashtë vendndodhjes së saj.

Marrëdhëniet e ndërsjella të ndërmarrjes me filialet rregullohen me aktin e krijimit dhe me kontratë ose marreveshje.

Ndërmarrja përgjigjet për detyrimet që mund t'u lindin filialeve gjatë zhvillimit të veprimtarisë ose ndërprerjes së saj.

Për veprimtari të një rëndësie të veçantë, si nafta, energjitika, kromi, bakri, hekuri, transporti, peshkimi, pyjet e ujërat, administrimi i pasurive natyrore të cilave bëhet në kuadrin e interesave kombëtare mund të krijohen bashkësi ekonomike me status të veçantë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 42

Organet drejtuese të ndërmarrjes janë:

a) Këshilli Drejtues

b) Drejtori

Mbledhja e përgjithshme ose e përfaqësisë zgjedh këshillin drejtues dhe këshillin e kontroll-revizionit.

Mbledhja e përgjithshme ose e përfaqësisë quhet e rregullt kur marrin pjesë 2/3 e anëtarëve të saj.

Ajo merr vendime me shumicë të zakonshme votash.

Neni 43

Anëtarët e Këshillit drejtues zgjidhen njëherë në dy vjet me të drejtën e përsëritjes së mandatit.

Anëtarë të Këshillit drejtues të ndërmarrjes mund të zgjidhen edhe persona që nuk janë në marrëdhënie juridike pune, me ndërmarrjen, me përjashtim të anëtarëve të qeverisë, drejtuesve të organeve të pushtetit lokal drejtorëve të përgjithshëm të bankave, gjyqtarëve, prokurorëve, hetuesve, arbitrave, noterëve dhe drejtorëve të drejtorive të Këshillit të Ministrave.

Drejtori i ndërmarrjes është anëtar i Këshillit drejtues.

Neni 44

Këshilli drejtues i ndërmarrjes ka këto kompetenca:

- a) Miraton statutin e ndërmarrjes;
- b) Miraton programin Për zhvillimin e ndërmarrjes;
- c) Miraton strukturën organizative të ndërmarrjes;
- ç) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Këshillit drejtues, drejtorin dhe zëvendësin e tij. Kur drejtori i ndërmarrjes emërohet ose largohet nga detyra, përpilohet një akt i veçantë në prani të një komisioni të caktuar nga Këshilli drejtues;
- d) Përcakton shpërblimin e punës të punonjësve dhe jep stimuj nxitës;
- dh) Merr vendime për krijimin, riorganizimin dhe ndërprerjen e filialeve;
- e) Miraton llogaritë vjetore dhe shpërndarjen e fitimit.

Neni 45

Anëtarët e Këshillit drejtues marrin shpërblimin vjetor për llogari të mjeteve financiare të ndërmarrjes dhe në vartësi nga rezultati përfundimtar i saj. Masa dhe kriteret e shpërblimit caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 46

Anëtarët e Këshillit drejtues për veprimtarinë e tyre mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave të veçanta ligjore.

Neni 47

Anëtarë të Këshillit të kontroll-revizionit mund të zgjidhen edhe persona që nuk janë në marrëdhënie juridike pune me ndërmarrjen.

Nuk mund të zgjidhen anëtarë të këtij këshilli personat e përcaktuar në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 48

Këshilli i kontroll-revizion kontrollon ekzekutimin e vendimeve të Këshillit drejtues dhe administrimin e pasurisë së ndërmarrjes.

Ai jep llogari për veprimtarinë e tij përpara mbledhjes së përgjithshme ose përfaqësisë.

Neni 49

Veprimtaria e përditshme e ndërmarrjes drejtohet nga drejtori dhe zëvendësi i tij.

Neni 50

Drejtori i ndërmarrjes ka këto të drejta:

- a) Organizon, drejton e kontroll veprimtarinë e ndërmarrjes dhe raporton për të.
- b) I propozon Këshillit drejtues programin ekonomiko-financiar e social të ndërmarrjes dhe përpunon masa për venien e tij në jetë, në përputhje me programet e miratuara.
- c) Përfaqëson ndërmarrjen në marrëdhënie me të tretët, me gjykatën dhe arbitrazhin, nënshkruan marrëveshje dhe kontrata në emër dhe për llogari të ndërmarrjes e të filialeve që ka në varësi dhe siguron zbatimin e tyre.

Ai mund të autorizojë persona të tjerë për ta drejtuar e përfaqësuar ndërmarrjen. Kur ai mungon në ndërmarrje për arsye të ndryshme, ngarkon zëvendësin e tij ose një person tjetër për drejtimin e saj.

d) Miraton çmimet sipas kompetencave të dhëna ndërmarrjes.

dh) Cakton rregullin e punës në ndërmarrje dhe emëron e shkarkon kryetarët e degëve, si dhe të gjithë nëpunësit e tjera dhe drejtuesit e filialeve.

Drejtori i ndërmarrjes ka këto detyra:

a) Përgjigjet dhe jep llogari përpara Këshillit drejtues dhe organit shtetëror, nga i cili varet për veprimtarinë e ndërmarrjes.

b) Përgjigjet për gjithë veprimtarinë ekonomike e financiare të ndërmarrjes dhe mban përgjegjësi materiale për dëme që mund t'i vijnë ndërmarrjes si pasojë e drejtimit nga ana e tij, sipas dispozitave në fuqi.

c) U jep zgjidhje të gjitha çështjeve që nuk janë në kompetencë të Këshillit drejtues.

Neni 51

Ndërmarrja organizohet e drejtohet sipas statutit të saj.

Statuti i ndërmarrjes, veç të tjerave duhet të përmbajë:

a) Numrin dhe datën e vendimit të organit që e ka krijuar ndërmarrjen.

b) Qëndren e ndërmarrjes.

c) Sasinë dhe mënyrën e formimit të vlerave me përdorim afatgjatë dhe të vlerave qarkulluese.

ç) Firmën e ndërmarrjes, të drejtën e nënshkrimit, kuhtet dhe kufijtë e nënshkrimit.

d) Mënyrën e krijimit të degëve e nëndegëve, vendndodhjen, veprimtarinë e tyre, organizimin, marrëdhëniet me qendrën.

dh) Të drejtat e drejtorit dhe marrëdhëniet e tij me degët, nëndegët filialet etj.

e) Rregullat për punën në ndërmarrje (Për mënyrën e marrjes në punë të punonjësve, pushimin nga puna të tyre, kualifikimin, shkollimin, pushimin vjetor etj.).

KREU V DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 52

Ndërmarrja mund të shndërrohet në subjekt privat ose në ndërmarrje të përbashkët në përputhje me dispozita ligjore në fuqi.

Neni 53

Për porositë shtetërore lidhet marrëveshje ndërmjet ndërmarrjes dhe organeve shtetërore që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 54

Ndërmarrja, jo më pak se një herë në vit, i nënshtrohet kontroll revizionit ekonomiko-financiar dhe zbatimit të ligjshmërisë nga organet shtetërore, të caktuara me ligj për këtë qëllim.

Neni 55

Ndërmarrja ka të drejtë t'u japë me qira pasurinë e saj, për një afat të caktuar ndërmarrjeve ose kooperativave të tjera, personave juridikë a fizikë, vendas a të huaj, kundrejt pagesës, sipas kriterëve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 56

Ligji nr.7373, datë 8.5.1990 "Për ndërmarrjet", dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 57

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1992

Shpallur me dekretin nr.71 datë 13.11.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia.